




# Hartëzimi i Lajmeve Lokale





Hartëzimi i  
Lajmeve Lokale  
në Televizionet  
Kombëtare në  
Shqipëri

Emiljano Kaziaj

## ‘Hartëzimi i lajmeve lokale’

2022

Autor: Dr. Emiljano Kaziaj

Grupi monitorues: Arbjona Çibuku, Elira Kadriu,  
Erisa Kryeziu

Redaktorë: Lorin Kadiu, Entenela Ndrevataj

Design: Trivet

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Friedrich Ebert Stiftung (FES) dhe Qendrën Citizens Channel. Asnjë pjesë e këtij studimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem për ruajtje të dhënash, ose të transmetohet, në mënyrë elektronike, mekanike apo me çfarëdo forme tjetër, pa cituar Friedrich Ebert Stiftung (FES) dhe Qendrën Citizens Channel.

Sqarim:

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Friedrich Ebert Stiftung (FES).

## Përmbajtja:

- 6-9 Hyrje
- 10-13 Përmbledhje e gjetjeve kryesore
- 14-15 Metodologjia
- 16-37 Gjetjet e studimit
  - 16-19 “Gjithçka ndodh në Tiranë”
  - 20-23 Ka qytete ku për 3 muaj “nuk ndodh asgjë”
  - 24-27 Tirana si realitet i fabrikuar
  - 28-31 Jashtë Tiranës ka dhunë, viktima dhe aksidente
  - 32-33 Nuk ka komunitete, vetëm individë
  - 34-37 Shumë pak korrespondentë, pak ekspertë, pak vox-pop dhe shumë politikanë
- 38-42 Rekomandime


## Hyrje

Ky studim merr në konsideratë lajmet e tre televizioneve kombëtare në Shqipëri: TV Klan, Top Channel dhe Vizion Plus. Edicionet qendrore të lajmeve të këtyre televizioneve u monitoruan për tre (3) muaj për periudhën 1 prill - 30 qershor 2022.

**Qëllimi i këtij  
monitorimi është të  
kuptuarit e  
mbulimit të lajmeve me  
natyrë lokale, në  
televizionet kombëtare.**

Duke u nisur nga ky qëllim,  
ky studim u jep përgjigje  
këtyre pyetjeve:





Studimi ndjek një qasje krahasuese të lajmeve lokale me lajmet qendrore, duke qenë se për të njëjtën periudhë, janë monitoruar edhe lajmet që lidhen me raportimet për institucionet qendrore. Ky komponent do përdoret vetëm për arsye krahasimi dhe nuk do analizohet më tej.

Sipas ligjit “Për mediat audiovizive ne Republikën e Shqipërisë”, operatorët me licencë transmetimi kombëtare, kanë si detyrim të mbulojnë të paktën 80% të territorit të vendit (Neni 55/2.b). Ndërkohë, neni 51/1 thekson që “...AMA mban parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare, me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore...”. Gjithashtu ligji përcakton se për marrjen e licencës operatorët duhet të “shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e informacionit dhe paanësinë e tij” (Neni 56/7).


Në rastin e licencave kombëtare dhe specifkisht në ofrimin e lajmeve kjo përkthehet në pluralizëm dhe diversitet të mbullimit të ngjarjeve duke pasur në mendje tematikat, çështjet dhe zonat e ndryshme, për të ofruar një shumëllojshmëri perspektivash si dhe për t’i shërbyer grupeve të ndryshme shoqërore dhe zonave të ndryshme.

Në këtë perspektivë, ky studim synon të tregojë se cilave grupe, tematikave apo institucioneve u shërbejnë më së shumti lajmet në televizionet kombëtare shqiptare. Gjithashtu, duke u nisur nga roli i lajmeve në krijimin e realiteteve sociale, ky studim synon të tregojë se cilat realitete theksojnë lajmet shqiptare dhe cilat realitete mungojnë në raportimin mediatik.




Ky studim është me interes për të gjithë profesionistët e gazetarisë pasi tregon se si puna e tyre duhet të ndikojë në informimin e të gjithë qytetarëve, të gjitha zonave dhe të gjitha grupeve të shoqërisë. Gjithashtu, gjetjet e këtij studimi mund t'u shërbejnë institucioneve monitoruese dhe rregulluese të mediave, për të siguruar që operatorët me licencë kombëtare po zbatojnë ligjin me mbulimin e çështjeve dhe zonave nga i gjithë territori i Shqipërisë.

Së fundmi, ky studim mund të jetë me interes për qytetarët për të kuptuar se si lajmet nëpërmjet narrativave të tyre të përsëritura na ndikojnë të menduarin mbi çështje, persona apo zona që marrin më shumë rëndësi në bazë të aksesit që kanë në media dhe pse çështje apo zona të tjera janë totalisht të harruara nga media dhe jashtë realitetit.



## Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Raporti i lajmeve për institucionet qendrore me ato të çështjeve lokale në tre televizionet kombëtare për një periudhë 3-mujore, është 70% me 30%.



# 40%

e lajmeve lokale i përkasin vetëm Tiranës.


Vetëm 18% të lajmeve në tre televizionet kombëtare, për 3 muaj raportojnë për ngjarje jashtë Tiranës.

---

Mesatarisht, i bie që në çdo televizion kombëtar, të kemi pasur vetëm 1 (një) lajm në ditë për gjithë Shqipërinë jashtë Tiranës.

---

Më shumë lajme janë raportuar nga rajoni dhe bota në të tre televizionet kombëtare, sesa nga gjithë Shqipëria jashtë Tiranës, për 3 muaj monitorim (588 kundrejt 571 lajme).



---

Nuk ka asnjë lajm të raportuar në 3 muaj nga të paktën 6 zona të Shqipërisë: Kolonja, Kuçova, Librazhdi, Mallakastër, Mati dhe Skrapari.

---

Lajmet nga Bashkia Tiranë janë më shumë se totali i lajmeve të prodhuara nga: Saranda, Kavaja, Kukësi, Dibra, Lushnja, Pogradeci, Kruja, Mirdita, Gjirokastra, Malësia e Madhe, Berati dhe Tropoja, të gjitha të marra së bashku, për një periudhë 3 mujore.

---

410 lajme ose 46% e totalit të lajmeve lokale, raportojnë për Krime/Dhunë dhe Viktima/Aksidente.

Lajmet lokale me tematika të rëndësishme si: Ekonomi, Natyrë/Mjedis apo Edukim zënë përkatësisht 4%, 3,4% dhe 1,5% të totalit të lajmeve.

---

Vetëm 15,5% e lajmeve lokale citojnë një ekspert nga zona ku po raportohet.

---


Në 18% të lajmeve me karakter lokal citohen politikanë.

---

Vetëm në 17.6% të rasteve citohen banorë të zonës.

---

Ka një shtim të reklamave të raportuara si lajme në edicionet qendrore, të cilat zvogëlojnë hapësirën që duhet t'i dedikohet ngjarjeve nga rrethet.




## Metodologjia

Në kuadër të këtij studimi janë kryer dy monitorime:


1/

Monitorim i tre televizioneve kombëtare për raportimin e çështjeve me karakter lokal.



2/

Monitorim i tre televizioneve kombëtare për raportimin e çështjeve me karakter qendror.




Për të dy këto monitorime, janë marrë në analizë lajmet e edicioneve qendrore të tre televizioneve me licencë kombëtare: TV Klan, Top Channel dhe Vizion Plus. Periudha e monitorimit ka qenë 3 mujore: 1 prill - 30 qershor 2022.

Për të dy monitorimet, janë përdorur dy formate të ndryshme regjistrimi. Për lajmet me karakter lokal elementi përcaktues ishte nëse në titull, pamje vizuale dhe përmbajtje të lajmit kishte referenca për qytete, rrethe apo ngjarje që prekin dhe ndodhin në një komunitet të caktuar. Këtu duhet theksuar se edhe për Bashkinë Tiranë, lajmet janë regjistruar si lajme lokale, pavarësisht raportimit nga Tirana që është qendër.

Për lajmet me karakter qendror, elementi përzgjedhës ishte nëse lajmi i referohej temave nga institucionet qendrore: Kryeministria, Presidenca, Ministritë, Kuvendi, institucione të varësisë si psh. Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe institucione qendrore të drejtësisë si psh. Prokuroria. Nëse ndonjë nga këto institucione bëhej lajm për ngjarje lokale, atëherë, është plotësuar forma e monitorimit për lajmet lokale.

Tre gazetarë: Arbjona Çibuku, Elira Kadriu dhe Erisa Kryeziu pas njohjes me instrumentin e monitorimit dhe qartësisë të procesit në një workshop të organizuar për këtë qëllim me autorin e studimit, punuan në mënyrë të pavarur për regjistrimin e lajmeve.

Në përfundim të procesit të monitorimit, databaza finale përmbante:



920 lajme me karakter lokal të monitoruara për periudhën prill - qershor 2022

2158 lajme me karakter qendror, për të njëjtën periudhë monitorimi

Analiza më poshtë është bazuar mbi këto të dhëna.

## GJETJET E STUDIMIT

# “Gjithçka ndodh në Tiranë”

Nga 3078 lajme të monitoruara në total, 2158 ose


**70%** e lajmeve i përkasin institucioneve qendrore të raportuara nga Tirana.

Vetëm 571 lajme janë raportuar për çdo zonë tjetër të Shqipërisë.


Vetëm 920 lajme apo 30% i përkasin temave apo çështjeve lokale.



Për të njëjtën periudhë monitorimi, në tre televizionet kombëtare janë transmetuar 588 lajme nga rajoni dhe bota, **ose 17 lajme më shumë nga rajoni** dhe bota sesa nga gjithë Shqipëria, jashtë Tiranës.




Në total **81%** e totalit të lajmeve (ose 2507 lajme) të transmetuara në 3 muaj në tre televizione kombëtare janë raportuar nga Tirana, për çështje të ndodhura në Tiranë.



Nga 920 lajme për çështjet lokale, 349 lajme apo **40%** i përkasin vetëm Tiranës.


Mesatarisht, i bie që në çdo televizion kombëtar, të kemi pasur vetëm **1 lajm në ditë për gjithë Shqipërinë jashtë Tiranës.**




**Reflektim:** Mungesa e lajmeve lokale për zonat e Shqipërisë jashtë Tiranës, lidhet me faktin që shumica e institucioneve politike, ekonomike, administrative, media-tike etj. ndodhen në Tiranë. Gjithsesi ajo që vihet re nga monitorimi është se mediat nuk përqendrohen tek tematika e mbulimit të çështjeve- pra të mbulojnë çështje me interes për të gjithë, por përqendrohen tek personazhet, kryesisht politikë.

Ky lloj raportimi, në vend që t'i shërbejë informimit të publikut për çështje me rëndësi për ta, i shërben më së pari promovimit personal apo partiak, të individëve të ndryshëm. Zonat jashtë Tiranës ngelen të painformuara dhe të pa përfaqësuar në media. Si pasojë, shqetësimet e banorëve të këtyre zonave nuk marrin rëndësi dhe hapësirë në raportimin mediatic.

Një fenomen që ndikon në zvogëlimin e hapësirës për lajmet me karakter lokal është edhe prioritizimi i kanaleve televizive të lajmeve -reklama por që "amballazhohen" në edicione lajmesh si ngjarje apo aktivitete. Disa të tilla raportohen edhe për disa ditë më radhë në edicionet informative. Shembuj të tillë janë:



«Gjithçka ndodh  
në Tiranë»




## Ka qytete ku për 3 muaj ‘nuk ndodh asgjë’


**Ku ka ndodhur ngjarja e raportuar  
në këtë lajm?**

342	————	Tiranë	7	————	Malësi
84	————	Vlorë	6	————	Berat
77	————	Shkodër	4	————	Tropojë
61	————	Durrës	4	————	Bulqizë
54	————	Lezhë	4	————	Pukë
44	————	Korçë	3	————	Tepelenë
28	————	Elbasan	2	————	Has
24	————	Fier	2	————	Devoll
21	————	Sarandë	1	————	Peqin
16	————	Kavajë	1	————	Delvinë
16	————	Kukës	1	————	Gramsh
12	————	Krujë			
11	————	Dibër			
10	————	Lushnjë			
10	————	Pogradec			
10	————	Kurbin			
9	————	Mirditë			
7	————	Gjirokastër			




Grafiku paraqet vetëm hartëzimin për <sup>2</sup> ngjarjet e raportuara si lajme lokale.




## Ka qytete ku për 3 muaj ‘nuk ndodh asgjë’



Një fenomen që vlen të përmendet është ‘bashkimi’ i disa raportimeve për ngjarje në rrethe, në një lajm të vetëm. Shembuj të tillë kemi:

<p>Stuhia mbush rrugët me gurë <i>Vizion Plus</i> (1.04.2022)</p>		<p>Katër viktime dhe katër të plagosur <i>Vizion Plus</i> (19.05.2022)<sup>5</sup></p>
<p>Arrestohen dy punonjës policie <i>Vizion Plus</i> (30.04.2022)<sup>4</sup></p>		

Ka edhe raste kur dy lajme të ndryshme të ndodhura në të njëjtën zonë, raportohen në një kronikë të vetme:



Këto fenomene, bashkimi i disa ngjarjeve të ndodhura në vende të ndryshme apo bashkimi i disa ngjarjeve të ndodhura në një zonë, në një lajm të vetëm, bëhet për arsye të ‘ekonomizimit’ të kohës së lajmeve. Arsye të tjera mund të jenë edhe mungesa e burimeve njerëzore si dërgimi i operatorëve apo gazetarëve në vendet ku ka ndodhur ngjarja. Gjithsesi efekti që këto lajme kanë është përforcimi i idesë se ngjarje të ndryshme lokale janë të pamjaftueshme për t’u bërë lajm të vetme dhe duhet bashkimi i dy ose më shumë ngjarjeve, në mënyrë që të marrë vlerë raportimi.


**Reflektim:** Dendësia e lajmeve të raportuara nga Tirana dhe për Tiranën çdo ditë, i jep një rëndësi të konsiderueshme kryeqytetit duke zbehur gjithçka tjetër ndodh në Shqipëri dhe duke formësuar mendimin se Tirana është i vetmi qytet i cili ofron mundësi për një jetesë më të mirë. Kjo shpjegon edhe shtimin e madh të popullsisë në Tiranë, e cila sjell si pasojë dobësimin e qyteteve të tjera dhe zvogëlimin e dëshirës për të jetuar aty.

Ndërkohë, lajmet lokale që të raportohen në edicionet e lajmeve u përforcohet artificialisht vlera e lajmit duke bashkuar disa ngjarje në një, si justifikim për të rritur ndikimin që ky lajm mund të ketë dhe vlerën për t’u raportuar.

## Tirana si realitet I fabrikuar

Numri i madh i ngjarjeve dhe lajmeve me karakter lokal të raportuara nga Tirana nuk ndjek një logjikë të pastër gazetarie. Jo të gjitha ngjarjet e raportuara nga Tirana dhe për Tiranën kanë vlerë lajmi apo përzgjidhen si të tilla pasi përmbushin kushtet e të bërit lajm apo përzgjidhen si pasojë e një procesi të pavarur raportimi dhe vendimarrjeje editoriale.

Nga një analizë e lajmeve lokale vetëm për Tiranën,  
del se:








nga këto lajme kanë në  
titull një referencë për  
kryebashkiakun Veliaj.

lajme në total në të tre  
televizionet i përkasin  
Bashkisë Tiranë apo çështjeve  
të lidhura me të.




Shembuj të këtyre titujve janë:

<p>Veliaj: Korsi të dedikuara autobuzi në Tiranë (TV Klan, 13.04.2022)</p>		<p>Veliaj takon socialistët e njësisë 4 dhe 7 (TV Klan, 11.06.2022)</p>
	<p>Veliaj: Mbollëm 114 mijë pemë këtë sezon (TV Klan, 22.04.2022)</p>	
<p>Veliaj: Kalendar për të rinjtë e Tiranës dhe Ferizaj (TV Klan, 27.04.2022)</p>	<p>Veliaj: Gati të përballem me Metën (Top Channel, 07.06.2022)</p>	<p>Veliaj takim me socialistet e njësisë 3 (TV Klan, 19.06.2022)</p>
<p>Veliaj takim me socialistet në njësinë 5 (TV Klan, 18.06.2022)</p>		<p>Veliaj takon socialistët e njësisë 4 dhe 7 (TV Klan, 11.06.2022)</p>
<p>Veliaj pret homologun nga Prizreni (Vizion Plus, 9.06.2022)</p>	<p>Veliaj pret homologun e Parmës (Vizion Plus, 26.05.2022)</p>	<p>Veliaj pret kryetarin e komunës së Suharekes (TV Klan, 23.04.2022)</p>
<p>Veliaj pret kreun e Federatës Botërore të Sportit Universitar (TV Klan, 06.05.2022)</p>	<p>Veliaj pret kryetaren e Këshillit të Kharkivit (TV Klan, 14.05.2022)</p>	
<p>Veliaj viziton të lënduarit (30.04.2022, Vizion Plus)</p>	<p>Veliaj: Mandatin tjetër një stadium të mbyllur për atletikën (TV Klan, 10.04.2022)</p>	<p>Veliaj sulmon Metën e Berishën (Vizion Plus, 29.06.2022)</p>
<p>Veliaj zbulon profilin e Presidentit të ri (Klan, 4.03.2022)</p>		<p>Veliaj pret drejtorin e Romës dhe kryebashkiakun e Parmës (TV Klan, 25.05.2022)</p>



Lajmet nga Bashkia Tiranë janë më shumë se totali i lajmeve të prodhuara nga: Saranda, Kavaja, Kukësi, Dibra, Lushnja, Pogradeci, Kruja, Mirdita, Gjirokastra, Malësi e Madhe, Berat dhe Tropojë, të gjitha të marra së bashku, për një periudhë 3 mujore.

Për më tepër, shumica e lajmeve të Bashkisë Tiranë, nuk janë raportime të hartuara sipas parimeve të gazetarisë. Të njëjtat pamje më të njëjtët tituj dhe të njëjtin tekst, raportohen në të gjitha televizionet e monitoruara. Në shumicën e këtyre lajmeve teksti i lajmit, lexohet nga folësi/folësja e lajmeve dhe jo nga një gazetar. Kjo sugjeron që për mbulimin e këtyre lajmeve që mund të raportojnë mbi ngjarje lokale, nuk ka pasur një gazetar në terren për hartimin dhe raportimin e lajmit. Teksti i lajmit duke qenë njësoj pavarësisht televizionit ku është transmetuar, vërteton që të gjitha elementët e lajmit: pamjet vizuale dhe teksti, janë të servirura tek televizionet si të gatshme. Duket se e njëjta qasje po përdoret gjithnjë e më dendur edhe nga institucionet të ndryshme qendrore për raportime lokale. Në shembujt më poshtë, nuk ka një gazetar në terren për raportimin e lajmit dhe teksti lexohet nga folësi/folësja e lajmeve:



Punimet në aksin e  
ri drejt Sarandës  
TV Klan (11.06.2022)

Vihet në punë  
hidrovori i Shllinzës  
TV Klan (4.4.2022)



Ndërkohë, lajmet të cilat raportojnë mbi ngjarje lokale me karakter zbatimin e ligjit, shumicën e herës nuk kanë gazetarë në terren për raportimin lajmeve dhe i marrin pamjet e gatshme nga institucionet përkatëse. Shumica e këtyre lajmeve raportojnë mbi ngjarje në lidhje me policinë, gjykatat dhe prokurorinë. Pamjet e servirura shpesh nuk lidhen me ngjaren e cila po tregohet, por janë të njëjtat pamje arkivore që jepen për shumicën e lajmeve me këto tema. Tekstet e lajmeve në këto raste lexohen nga folësi/folësja e lajmeve. Shembuj të tilla janë:


	<p>IKMT prish hotelin 3 katësh në Radhimë <i>TV Klan (5.4.2022)</i></p>	
<p>Zbardhen 9 vjedhje të ndodhura në Tiranë <i>TV Klan (4.3.2022)</i></p>		
	<p>Përplasje me armë në Lezhë, burg për dy të plagosurit <i>TV Klan (4.4.2022)</i></p>	<p>Sekuestrohen 72 kg kanabis në Devoll <i>TV Klan (8.4.2022)</i></p>
		<p>Sekuestrohen 5 milionë euro pasuri të Gentian Sharrës <i>TV Klan (10.6.2022)</i></p>

## Jashtë Tiranës ka dhunë, viktima dhe aksidente

### TEMAT QË TRAJTON LAJMI:

260	—	Krime/Dhunë
150	—	Viktimë/Aksidente
112	—	Politikë/Qeverisje/Ligje
66	—	Sport
58	—	Art/Media/Kulturë
39	—	Tjetër
37	—	Ekonomi
31	—	Natyrë/Mjedis
27	—	Shëndetësi/Siguri
24	—	Argëtim
14	—	Edukim
14	—	Fatkeqësi Natyrore
13	—	Korrupsion
12	—	Festime
12	—	Shkencë/Inovacion/Teknologji
8	—	Migracion
6	—	Kuriozitete
5	—	Fe dhe Besime Fetare

Këto shembuj i përkasin vetëm raportimeve lokale. Lajmet qendrore ku institucionet fabrikojnë lajme të gatshme për mediat, është mjaft i përhapur.<sup>6</sup>



Siç mund të shihet në grafikon më sipër, nga analiza e tematikave që trajtohen në 888<sup>7</sup> lajme lokale në total, rezulton se 410 lajme, raportojnë për krime/dhunë dhe viktima/aksidente.

Kjo shifër përbën 46% të të gjitha lajmeve lokale.

Për më tepër:



Lajmet lokale me tematika të rëndësishme si: **Ekonomi, Natyrë/Mjedis apo Edukim** zënë përkatësisht 4%, 3,4% dhe 1,5% të totalit të lajmeve.

Në 112 lajme me tematikë **Politikë/Qeverisje/Ligje**, 76 lajme ose 68% raportojnë nga Tirana dhe për Tiranën.

Nga 58 lajme me tematikë **Art/Media/Kulturë**, 33 lajme ose 57% raportojnë nga dhe për Tiranën.

Nga 260 lajme në total për tematikën **Krime/Dhunë** vetëm 21% (55 lajme) raportojnë nga Tirana dhe për Tiranën.

10 nga 12 lajme në total për kategorinë **Shkencë/Teknologji** raportohen nga Tirana dhe për Tiranën

Të gjitha lajmet për **Fatkeqësi Natyrore** i përkasin rrethëve të tjera, jo Tiranës.


**Reflektim:** Ka një dominim të dukshëm të lajmeve nga Tirana dhe për Tiranën për ato tematika lajmesh që konsiderohen si më të rëndësishme dhe pozitive apo të rëndësishme si: Politikë/Ligje/Qeverisje, Art/Media/Kulturë, Argëtim, Shkencë/Teknologji apo Ekonomi, dhe një dominim të gjithë pjesës tjetër të Shqipërisë për lajme me tematikë fenomene negative si Krime/Dhunë, Viktima/Aksidente, Fatkeqësi Natyrore etj. Lajmet e përsëritura për rrethet e tjera, që gjatë gjithë kohës mbulojnë fenomene negative të ndodhura në këto rrethe, formësojnë një realitet deprimues si për ata që jetojnë në ato rrethe, si për njerëzit që kanë ardhur të jetojnë në Tiranë dhe vendosin të mos kthehen më aty.

## Nuk ka komunitete, vetëm individë

Siç shihet nga grafiku më sipër, shumica e lajmeve me karakter lokal nuk fokusohen tek ngjarje apo tematika që prekin të gjithë komunitetin nga ku po raportohet ngjarja, por fokusohen tek individë të caktuar. Lajme të tilla janë përshembull raportimet mbi aksidentet rrugore, rasteve të krimit dhe dhunës apo daljet e politikanëve lokalë në media. Në raportime të tilla edhe pse ka vend për të bërë një reflektim se si kjo ngjarje e ndikon komunitetin nga ku raportohet (psh në rastin e aksidenteve rrugore mund të bëhet një reflektim për përmirësimet e sinjalistikës në atë segment rrugor apo masa të tjera që mund t'i shërbejnë komunitetit) kjo gjë nuk ndodh. Raportimi i ngjarjeve me tematika lokale, me fokus në vetëm një apo disa individë, nuk i shërben adresimit të problematikave të komunitetit.








## Shumë pak korrespondentë, pak ekspertë, pak vox-pop-e dhe shumë politikanë

*Nga të dhënat e mbledhura rezulton se:*

Vetëm **52,1%**  
(ose gjysma) e  
lajmeve lokale të  
monitoruara  
raportohen nga  
korrespondentë në  
terren.

Ky lajm raportohet nga  
një korrespondent/e në  
terren


888 përgjigje



Në **18%**  
të rasteve në  
lajmet me karakter  
lokal citohen  
politikanë


Ky lajm citon një  
politikan/e për temën  
për të cilën po  
raportohet

888 përgjigje




Vetëm **15,5%**  
e lajmeve lokale  
citojnë një  
ekspert nga zona ku  
po raportohet

Ky lajm citon një  
ekspert/e nga zona për  
të cilën po raportohet  
888 përgjigje





Vetëm në **17.6%**  
të rasteve citohen  
banorë të zonës.

Ky lajm përfshin një ose  
disa vox pop nga banorët  
të zonës mbi temën për të  
cilën po raportohet  
888 përgjigje



Një analizë më e hollësishme e këtyre të dhënave tregon se rreth 47% e ekspertëve të cituar në lajmet me karakter lokal i përkasin Tiranës (65 lajme nga 138 lajme në total ku citohen ekspertë). Gjithashtu, rreth 70% e politikanëve të cituar në lajmet me karakter lokal i përkasin Tiranës. Një gjetje interesante është fakti që politikanët e cituar në lajme me karakter lokal për Tiranën, më së shumti flasin për tematikat: Argëtim, Art/Media/Kulturë dhe Sport. Shumica e këtyre lajmeve lidhen me aktivitete të Bashkisë Tiranë.

Në disa raste të citimit të ekspertëve apo politikanëve, nuk ka një intervistë me ekspertin apo politikanin që përmendet por citimi është marrë nga deklaratat për shtyp e institucionit. Gazetarët që raportojnë mbi ngjarjet lokale, jo gjithmonë intervistojnë vetë ekspertë lokalë apo politikanë për të marrë perpspektivat e tyre për ngjarjen në fjalë. Mjaftohen vetëm me deklaratën për shtyp të institucionit, pa verifikuar vërtetësinë e përmbajtjes së fakteve të paraqitura aty nga ekspertët apo politikanët. Shembuj të tillë janë:

Projektet për Tiranën <i>Top Channel</i> (18.05.2022)		Punimet në aksin e ri drejt Sarandës <i>TV Klan</i> (11.06.2022)
	Porti i Durrësit dhe Prishtinës <i>Top Channel</i> (21.05.2022)	Bllokohen 5 milionë euro <i>Top Channel</i> (10.06.2022)
Vihet në punë hidrovori i Shllinzës <i>TV Klan</i> (3.4.2022)		

**Reflektim:** Fakti që shumica e lajmeve me karakter lokal të raportuara nga jashtë Tiranës, nuk kanë një korrespondent në terren, tregon për mungesën e rëndësisë së lajmeve lokale në televizionet kombëtare. Gjithashtu fakti që në lajmet lokale të raportuara mungojnë elementë kryesorë të një lajmi si: një gazetar në terren, citimi i ekspertëve lokalë apo zëri i banorëve të atyre komuniteteve (vox-pop), tregojnë se për lajmet me karakter lokal (përjashtoj Tiranën) bëhen raportime episodike dhe të mangëta dhe duket se elementi përzgjedhës i lajmit është sensacioni (krimi, dhuna, aksidentet) dhe jo ndikimi i ngjarjes tek një shumicë e caktuar apo tek një komunitet (siç mund të ishin ngjarjet për ekonominë, natyrën, edukimin, etj).

Dy elementët kryesorë të përzgjedhjes së një lajmi që janë ndikimi (impact)-tek sa më shumë njerëz dhe afërsia (proximity)- sa afër njerëzve apo komunitetit ndodh ngjarja- nuk merren parasysh e televizioneve kombëtare. Në të kundërt duket se elementët përzgjedhës të lajmit janë: sensacioni dhe personalizimi. Përsëritja e vazhdueshme e vetëm këtyre dy kriterëve si përzgjedhës të lajmeve çon në pasqyrimin e çështjeve dhe realitetit të shtrembëruar, forcon pozitat e vetëm disa individëve të caktuar dhe nuk adreson/pasqyron problemet reale të komuniteteve. Si pasojë edhe masat për zgjidhjen e këtyre problemeve, mungojnë.

## REKOMANDIME

### Opratorët televizivë

- Duhet të bëjnë një mbulim më domethënës të territorit të Shqipërisë jo vetëm si sinjal por edhe si përmbajtje mediatike sidomos për lajmet, në përputhje me statusin e licencës së marrë si licencë kombëtare.
- Zgjerimin e rrjetit të gazetarëve lokalë si burimet më të vyera njerëzore për median të cilët kanë aksesin dhe njohuritë mbi ngjarjet, institucionet dhe komunitetet lokale, si elementë kyç për një raportim sa më të pavarur, gjithëpërfshirës dhe domethënës.
- Mospranimin e kronikave të gatshme nga institucionet qendrore apo lokale. Një fenomen i tillë e zhvlerëson profesionin e gazetarit duke servitur ngjarje apo lajme që i shërbejnë interesave të ngushta të një grupi njerëzish dhe jo publikut.
- Ndarjen e qartë të lajmeve nga reklamat. Hapësira e dedikuar reklamave në edicionet informative heq mundësinë e raportimit të më shumë lajmeve nga rrethet që kanë një rëndësi jetike dhe ndikim të madh në komunitetet përkatëse, por që çështjet e tyre mbeten të paraportuara.

## Autoritetet e monitorimit të medias

Duhet të rikthejnë fokusin tek parimet e të bërit gazetarit duke vlerësuar ngjarjet që përbëjnë lajm sipas kritereve të përcaktuara qartë për profesionin e gazetarit, duke i mëshuar elementëve si: ndikimit tek sa më shumë njerëz, afërsisë me njerëzit apo komunitetin ku ndodh ngjarja, informacionit të dhënë në kohën e duhur, ngjarjet që shpjegojnë konflikte të mundshme dhe propozojnë zgjidhje, ngjarjet që përfshijnë figura me interes të lartë shoqëror, ngjarjet që hedhin dritë mbi shoqërinë dhe fenomenet që na ndikojnë si shoqëri, etj.

Nuk duhet të mjaftohen me deklaratat për shtyp apo komunikimet e institucioneve qendrore apo lokale, por duhet të thellohen në informacionet e marra duke verifikuar faktet, deklaratat apo shifrat dhe duke i shpjeguar ato për publikun e gjerë me fokus në ndikimin që ato kanë për komunitetet apo grupet shoqërore.

## REKOMANDIME

### Organizata ndërkombëtare që kanë në fokus gazetarinë dhe lirinë e shprehjes

- Duhet të ngrenë zërin për çdo praktikë të ndjekur në mediat audiovizive që cenon integritetin e të bërit gazetari në Shqipëri.
- Duhet të ngrenë zërin për çdo rast të evidentuar të ndikimit të pronësisë së medias në përmbajtjen e lajmeve dhe të informacioneve.
- Duhet të ngrenë zërin për çdo rast të evidentuar të ndikimit të politikës në përmbajtjen e lajmeve dhe informacionit.
- Duhet të mbështesin më shumë gazetarë lokale dhe korrespondentë në rrethe me rritje kapacitetesh dhe mundësi me të shtuara për përvoja profesionale.
- Hartimin e studimeve mbi monitorimin e lajmeve dhe ndarja e gjetjeve me institucionet përkatëse, shoqëruar me iniciativa për përmirësimin e situatës duke iu referuar evidencave dhe gjetjeve të studimeve të kryera.



## Organizata ndërkombëtare, kombëtare apo lokale që kanë në fokus zhvillimin komunitar

- Duhet të mbështesin edhe me shumë grupet komunitare me të cilat punojnë për një advokim më të fortë me median që zëri i tyre- veçanërisht i komuniteteve në rrethe jashtë Tiranës- të dëgjohej në media dhe që çështjet e tyre të mbulohen.
- Duhet të punojnë ngushtësisht me gazetarët lokale në ofrimin e sa më shumë tematikave apo çështjeve të komuniteteve me të cilat punojnë.
- Duhet të përfshijnë në punën e tyre stafe të cilët të kenë si detyrë specifike marrëdhënien me median.
- Duhet të ndërgjegjësojnë në mënyrë të vazhdueshme grupet me të cilat punojnë për rëndësinë e ngritjes së zërit në media dhe dhënies vizibilitet çështjeve që i shqetësojnë si një hap i parë dhe i rëndësishëm për adresimin e tyre.

## REKOMANDIME


### Institucionet e formimit të gazetarëve

- Duhet të theksojnë në mënyrë të vazhdueshme, gjatë gjithë procesit të formimit të gazetarëve të rinj rëndësinë që kanë parimet e gazetarisë mbi gjithëpërfshirjen, për zhvillimin e një shoqërie demokratike.
- Duhet të theksojnë në kurrikulat e tyre dhe gjatë procesit të mësimdhënies, sa më shumë çështje me fokus lokal dhe rëndësinë e gazetarëve të cilët mund të punojnë si korrespondentë (duke u fokusuar në shembuj që raportojnë mbi çështje komunitare, mbulim të rretheve apo çështjeve të zonave të tjera të Shqipërisë, jashtë Tiranës).
- Duhet të identifikojnë dhe theksojnë për studentët e tyre ato praktika të të bërit gazetari që po e cenojnë integritetin e profesionit (si fenomenet e përmendura më sipër: marrja e lajmeve të gatshme nga institucione qendrore apo lokale; mosverifikimi i deklaratave të dhëna për shtyp; leximi i lajmeve të parapërgatitura, etj).



## Shënime

- 1/ Për çdo pyetje rreth monitorimit, formave të monitorimit apo të dhënave të mbledhura ju lutem kontaktoni autorin e studimit nëpërmjet adresës: [emiljanokaziaj@gmail.com](mailto:emiljanokaziaj@gmail.com)
- 2/ Grafiku paraqet vetëm hartëzimin për ngjarjet e raportuara si lajme lokale.
- 3/ Këtu kemi kategorizuar vetëm lajmet që prekin Tiranën si zonë, jo si qendër politike, ekonomike, kulturore, etj. Lajmet nga kryeministria, presidenca, opozita, institucionet e drejtësisë, etj janë monitoruar tek lajmet qendrore dhe nuk janë pjesë e kësaj analize.
- 4/ Lajmi lidhet me dy ngjarje të ndryshme, një e ndodhur në Vlorë dhe tjetra në Korçë
- 5/ Ngjarje të ndodhura në Milot dhe Kalimash
- 6/ Këto shembuj i përkasin vetëm raportimeve lokale. Lajmet qendrore ku institucionet fabrikojnë lajme të gatshme për mediat, është mjaft i përhapur.
- 7/ Nga totali i 920 lajmeve të raportuara për çështje lokale, janë lënë jashtë analizës ato lajme që nuk janë mundur të kategorizohen si tematikë.



# Hartëzimi i Lajmeve Lokale

Emiljano Kaziaj

FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG



Citizens  
Channel